



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET  
"HAXHI ZEKA"

REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA E KOSOVË MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI		
Nr. / Br. / No. <u>1490</u>	Nr. i faq/ @r. str / No. pg <u>3</u>	
Data / Datum / Date: <u>08.06.2026</u> Pejë / Peë		

Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë

Pejë, më 08.06.2026

Në bazë të nenit 15, të Rregullores për Veprimtarinë Kërkimore – Shkencore dhe Artistike ref. nr. 846/24, e dt. 29.03.2024, Universiteti "Haxhi Zeka" më datë 08.06.2026, shpall këtë:

### THIRRJE

#### Për ndarjen e çmimit vjetor "Hulumtuesi i vitit 2025" & "Artisti i vitit 2025"

Universiteti "Haxhi Zeka", ka ndarë fondin për çmimin vjetor për rezultate të jashtëzakonshme kërkimore-shkencore brenda vitit kalendarik 2025. Nëpërmjet ndarjes së këtyre çmimeve synohet promovimi i cilësisë në punën shkencore, si dhe të inkurajohet ngritja në karrierë dhe shpërblimi i përpjekjeve dhe përkushtimi i hulumtuesve shkencorë apo veprimtarisë artistike.

Këtë vit do të ndahen 4 çmime për Hulumtuesin e vitit dhe 1 çmim për Artistin e vitit në njësitë akademike si në vijim:

1. Fakulteti i biznesit: 1 (një) çmim, Hulumtuesi i vitit;
2. Fakulteti Juridik: 1 (një) çmim, Hulumtuesi i vitit;
3. Fakulteti për Menaxhim në Turizëm, Hotelieri dhe Mjedis: 1 (një) çmim, Hulumtuesi i vitit;
4. Fakulteti i Agrobiznesit: 1 (një) çmim, Hulumtuesi i vitit;
5. Fakulteti i Arteve: 1 (një) çmim, Artisti i vitit.

#### I. KUSHTET E PËRGJITHSHME TË APLIKIMIT

1. Punimet shkencore/veprat artistike, librat, monografitë, projekte shkencore, pjesëmarrja në konferenca shkencore ndërkombëtare, pjesëmarrja në koncerte ndërkombëtare, dhe gjitha aktivitetet tjera, duhet të jenë të realizuara brenda vitit 2025.
2. Punimet duhet të jenë të publikuara në njërin nga platformat si në vijim:
  - a) WEB OF SCIENCE (SCIE, SSCI, dhe AHCI);
  - b) SCOPUS (Q1, Q2, Q3, Q4).

3. Më rastin e aplikimit, mësimdhënësit/asistentët/korepetitorët duhet të dorëzojnë dokumentet e tyre në mënyrë elektronike, si dhe vegëzën për secilin aktivitet shkencor sipas pikës 2 të kësaj thirrje.
4. Të drejtë aplikimi kanë i gjithë stafi i rregullt akademik i UHZ-së.

## **II. MËNYRA E PËRZGJEDHJES**

1. Përzgjedhja bëhet në bazë të:
  - a) Numrit të punimeve shkencore;
  - b) Numrit të kërkimeve shkencore (si p.sh. studimet post doktorale, apo të ngjashme);
  - c) Numrit të librave/kapitujve të botuara;
  - d) Numrit të monografive të botuara;
  - e) Numrit të projekteve shkencore/kulturore të fituara apo pjesëmarrje;
  - f) Numrit të pjesëmarrjes në konferenca shkencore ndërkombëtare;
  - g) Numrit të aktiviteteve muzikore ndërkombëtare;
  - h) Numrit të pjesëmarrjes në festivale/koncerte ndërkombëtare.
2. Kriteret për çmimin "Hulumtuesi i vitit" janë:
  - a) Aplikuesi duhet të jetë autor i parë apo autor korrespondent;
  - b) Punimet me të cilat aplikon duhet të jenë të indeksuara në WEB OF SCIENCE (SCIE, SSCI, AHCI) ose SCOPUS (Q1, Q2, Q3, Q4);
  - c) Punimet duhet të jenë të publikuara në revista që kanë impakt faktor më të lartë;
  - d) Punimet duhet të jenë të publikuara në revista kredibile;
  - e) Punimet duhet të kenë numrin më të lartë të citimeve;
  - f) Punimet duhet të jenë të fushës së aplikuesit;
  - g) Punimet duhet të kenë kontribut social;
  - h) Kërkimet shkencore të jenë të fushës së aplikuesit;
  - i) Librat/kapitujt duhet të jenë të fushës së aplikuesit;
  - j) Monografit duhet të jenë të fushës së aplikuesit;
  - k) Projekte shkencore/kulturore duhet të jenë të fushës së aplikuesit;
  - l) Pjesëmarrja në konferenca shkencore ndërkombëtare të jenë të fushës së aplikuesit;
  - m) Aktivitete muzikore ndërkombëtare të jenë të fushës së aplikuesit;
  - n) Pjesëmarrja në festivale-koncerte ndërkombëtare duhet të jenë të fushës së aplikuesit.

## **III. SHPERBLIMET**

1. Grupi për Kërkime Shkencore është përgjegjës për pranimin dhe shqyrtimin e aplikacioneve, si dhe propozimin e kandidatëve të cilët i plotësojnë kushtet e parapara.

2. Shpërblimi i takon autorit të parë apo autorit korrespondent në punimin shkencor/veprën artistike në vlerën monetare prej 500 euro për secilin çmim nga njësitë përkatëse akademike, si dhe në vlerë jo-monetare ndarja e certifikatës.

Thirrja mbetet e hapur deri më 15.06.2026.

Dëshmitë e kërkuara sipas pikës 2 të kësaj thirrje duhet të dorëzohen në formë elektronike në postën elektronike: [apliko.online@unhz.eu](mailto:apliko.online@unhz.eu) dhe pastaj në formë fizike në zyrën e protokollit në Rektorat nga ora 09:00 deri në orën 15:00. Dokumentet e dorëzuar pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Thirrjen mund ta gjeni të publikuar edhe në ueb faqen zyrtare.